

## Abstrakt

Qëllimi i kësaj teme të masterit është të trajtohen dhe të studiohen aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës lidhur me shkeljen e Kushtetutës nga Presidenti si dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese së Shqipërisë me rastin e shkeljes së Kushtetutës nga Presidenti.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës lidhur me rastin e z.Fatmir Sejdiu - vendosi për konstatimin se ka shkelje serioze të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, respektivisht të nenit 88.2, të Kushtetutës, z.Fatmir Sejdiu, duke mbajtur njëkohësisht postin e Presidentit të Kosovës si dhe postin e kryetarit të partisë politike – Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK-së.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës lidhur me rastin e z.Behgjet Pacollit - pas vlerësimit dhe analizimit të provave gjykata kishte vendosur të shpallte jo kushtetues vendimin e kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, me 22 shkurt 2011.

Ndërsa Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë lidhur me rastin e z.Ilir Metes - pasi përcaktoi elementet objektive të “shkeljes së rëndë të Kushtetutës” të parashikuar në nenin 90, pika 2, të Kushtetutës, si dhe vlerësoi kërkesën e nenit 90, pika 3, të Kushtetutës për të vërtetuar fajësinë e Presidentit, arriti në përfundimin se:

1. Faktet e paraqitura si shkelje të nenit 86, pika 1, dhe nenit 89 të Kushtetutës, nuk përbëjnë shkelje të rënda të Kushtetutës.
2. Nuk ka shkelje të rëndë të nenit 88, pika 3, të Kushtetutës,
3. Faktet e paraqitura si shkelje të nenit 94 të Kushtetutës nuk përbëjnë shkelje të Kushtetutës.

Për këto arsye vendosi shfuqizimin e vendimit nr. 55/2021, datë 09.06.2021 të Kuvendit të Shqipërisë “Për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë për shkelje të rënda të Kushtetutës”.

**Fjalët kyçe: Kushtetuta, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Aktgjykime, Vendime.**